



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS
TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

GJEOGRAFIA E KRIMIT (2013-2018)

PËRFSHIRJA E PERSONAVE NË VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE
TË MEKANIZMIT PËRCJELLËS NDËRINSTITUCIONAL

Përgatitur nga koordinatori nacional për
Mekanizmin Përcjellës Ndërinstitucional (MPN)

Nëntor 2019, Prishtinë

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	3
I. Demografia në këndvështrimin penal.....	4
1.1 Numri i banorëve resident dhe përgjegjshmëria penale.....	4
1.2 Panorama e banorëve resident sipas kompetencës territoriale.....	5
II. Ndjekja penale.....	6
2.1 Përfshirja në rastet penale.....	6
2.2 Të dyshuarit për kryerjen e veprave penale.....	7
2.3 Panorama gjeografike e të dyshuarve.....	8
2.4 Ndjekja penale në dimensionin kohor.....	9
2.5 Profili territorial i të dyshuarve për veprat penale karakteristike.....	10
2.5.1 Armët.....	11
2.5.2 Drogat.....	12
2.5.3 Kontrabandimi me migrant.....	13
2.5.4 Korrupsioni.....	14
2.5.5 Trafikimi me njerëz.....	15
2.5.6 Krimet ekonomike.....	16
2.5.7 Nxitja e urrejtjes.....	17
III Akuza.....	18
3.1 Të akuzuarit për veprat penale karakteristike.....	18
3.2 Profili i të akuzuarëve.....	19
3.3 Panorama gjeografike e të akuzuarve.....	20
3.4 Akuzimi në dimensionin kohor.....	21
3.5 Profili territorial i të akuzuarve për veprat penale karakteristike.....	22
3.5.1 Armët.....	23
3.5.2 Drogat.....	24
3.5.3 Kontrabandimi me migrant.....	25
3.5.4 Korrupsioni.....	26
3.5.5 Trafikimi me njerëz.....	27
3.5.6 Krimet ekonomike.....	28
3.5.7 Nxitja e urrejtjes.....	29
IV Gjykimi.....	30
4.1 Vendimet e gjykatës.....	30
4.2 Profili i të dënuarëve.....	31
4.3 Dënimi në dimensionin kohor.....	32
4.4 Profili territorial i të dënuarve për veprat penale karakteristike.....	33
4.4.1 Armë.....	34
4.4.2 Drogat.....	35
4.4.3 Kontrabandimi me migrant.....	36
4.4.4 Korrupsioni.....	37
4.4.5 Trafikimi me njerëz.....	38
4.4.6 Krimet ekonomike.....	39
4.4.7 Nxitja e urrejtjes.....	40
V Konstatime.....	41
VI Rekomandime.....	47
Përfundim.....	56

HYRJE

Mekanizmi përcjellës ndërinstitucional¹ është një sistem për harmonizimin e të dhënave në mes të institucioneve lidhur me personat e dyshuar, të ndjekur penalisht dhe të gjykuar, për shtatëdhjetë e një (71), vepra penale karakteristike², nga Kodi Penal i Kosovës.

Për hartimin e këtij raporti janë përdorur të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, mbi numrin e banorëve resident të Republikën e Kosovës, sipas regjistrimit të vitit 2011, ndërsa ndarja e numrit të banorëve sipas kriterit të përgjegjësisë penale, për 38 komunat është bërë nga autorit me qëllim të realizimit të analizës, objekt të këtij raporti.

Për qëllim të këtij raporti të gjitha të dhënat statistikore për numrin e banorëve resident, të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç), nëpër komuna janë grupuar në shtatë (7) rajone, sipas ndarjes territoriale të shtatë (7) prokurorive themelore të Republikës së Kosovës.

Qëllimi parësor i këtij raporti është identifikimi i përhapjes gjeografike të kriminalitetit (*vetëm për veprat penale karakteristike*), në nivel të Republikës në përgjithësi dhe rajoneve sipas kompetencës territoriale të prokurorive themelore në veçanti.

Objekt i analizës në kuadër të këtij raporti janë personat e dyshuar, të akuzuar dhe të dënuar për veprat penale karakteristike përgjatë viteve 2013-2018, të cilët sipas shtrirjes territoriale pasqyrojnë profilin rajonal të të dyshuarve, të akuzuarve dhe të dënuarve.

Synimi i kësaj analize është identifikimi i profilit të të dyshuarve, të akuzuarve dhe të dënuarve me qëllim të kategorizimit të veprave penale sipas nivelit sasior të personave të përfshirë në raport me territorin nën kompetencën e prokurorive themelore respektive, që si të tilla këto të dhënave gjenerojnë rekomandimet konkrete për profilizimin e prokurorëve dhe prokurorive në bazë të profilit të të dyshuarve, të akuzuarve dhe të dënuarve në aspektin kompetencës territoriale.

Struktura e këtij raporti fillimisht pasqyron numrin e banorëve të përgjegjshëm penalisht në nivel të Republikës (14+vjeç), të kategorizuar sipas rajoneve dhe informatat sasiore për numrin e personave të dyshuar për përfshirje në veprat penale karakteristike.

Raporti në vazhdim adreson aspektin krahasimor të ndjekjes penale, akuzimit dhe dënimit të kryesve të veprave penale karakteristike, duke nxjerrë edhe profilin e personave sipas llojit të veprës penale dhe kompetencës territoriale të prokurorive themelore. Raporti pas ndjekjes penale trajton aspektin e të dënuarve me aktgjykim të gjykatës së shkallës së parë.

Pjesa e fundit e këtij raporti përmban konstatimet dhe rekomandimet e përgjithshme dhe të veçanta përmes realizimit të të cilave pretendohet të ngritet niveli i performancës në hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e personave të përfshirë në veprat penale karakteristike.

¹ Këshilli Prokurorial, Këshilli Gjyqësor, Policia, Agjencioni Kundër Korrupsionit, Dogana, Eulex, Administrata Tatimore, Inspektoriati Policor, Njësia Inteligjencës Financiare, Zyra auditorit general, autoriteti pyjor, Agjencioni Kosovar i Pronës, Organi i Administratës Komunale, i dëmtuari, Prokurori me vetiniciativë, Titullari i pronës dhe qytetari.

² Armët (1), Drogat (8), Kontrabandimi me migrant (1), Krimi organizuar (1), Korrupsionit (20), Shpërlarja e parasë (1), Trafikimi me njerëz (7), Krimet ekonomike (31) dhe Nxitja urrejtes (1).

I. DEMOGRAFIA NË KËNDVËSHTRIMIN PENAL

1.1 NUMRI I BANORËVE RESIDENT DHE PËRGJEGJSHMËRIA PENALE

Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2011 dhe vlerësimit të popullsisë³ në komunitat në të cilat nuk është bërë regjistrimi, rezulton se në Republikën e Kosovës jetojnë: 1.780.021 banorëve resident. Sipas kriterit të përgjegjësisë penale (*moshës*), rezulton se 1.281.204 banorë janë penalisht të përgjegjshëm (të moshës 14 vjeç e mbi), ndërsa 498.817 banorë janë penalisht të papërgjegjshëm⁴ (të moshës nën 14 vjeç), (shih figurën 1).

#	PROKURORIA/ RAJONI	Numri i banorëve resident	Penalisht të përgjegjshëm (14+ vjeç)	Penalisht të papërgjegjshëm (-14 vjeç)
1	PRISHTINË	470.583	338.804	131.779
2	PRIZREN	277.007	199.915	77.092
3	MITROVICË	232.833	166.577	66.256
4	PEJË	220.338	160.986	59.352
5	GJAKOVË	205.377	145.156	60.221
6	GJILAN	188.188	138.348	49.840
7	FERIZAJ	185.695	131.418	54.277
	Gjithsej:	1.780.021	1.281.204	498.817

Figura 1

Rajoni i Prishtinës, rezulton të ketë numrin më të lartë të banorëve të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç), me **26.44%**, ndërsa Ferizaji numrin më të ulët, me **10.26%** (shih figurën 2).




Figura 2

³ Me termin "Numri i popullsisë" i referohemi procesit të regjistrimit të vitit 2011 nga Qeveria e Kosovës.

⁴ "Personi nuk është penalisht përgjegjës nëse në kohën e kryerjes së veprës penale është nën moshën katërmëdhjetë (14) vjet", paragrafi 3, nga neni 17 (përgjegjësia penale), të Kodit Penal të Kosovës.

1.2 PANORAMA E BANORËVE RESIDENT SIPAS KOMPETENCËS TERRITORIALE

Meqenëse, Prokuroritë Themelore kanë kompetencë territoriale në komunat përkatëse, përmes tabelës, si më poshtë, pasqyrojmë komunat përkatëse që bëjnë pjesë në kuadër të rajoneve, duke përfshirë edhe të dhënat statistikore për numrin e banorëve resident, të përgjegjshëm penalisht si dhe numrin e banorëve penalisht të papërgjegjshëm (shih figurën 3).

RAJONET	KOMUNA	Numri banorëve resident dhe pjesëmarrja në % në nivel vendi	Numri i banorëve penalisht të përgjegjshëm (14+vjeç), dhe pjesëmarrja në % në nivel vendi	Numri i banorëve penalisht të papërgjegjshëm (-14vjeç), dhe pjesëmarrja në % në nivel vendi
PRISHTINA: 470.583 banorë (338.804, me14+vjeç dhe 131.7792 nën 14 vjeç)	1 Prishtinë	198897 apo 11.17%	14749 apo 11.51%	51403 apo 10.30%
	2 Podujevë	88499 apo 4.97%	61691 apo 4.81%	26808 apo 5.37%
	3 Glogoc	58531 3.29%	41236 apo 3.22%	17295 apo 3.47%
	4 Lipjan	57605 apo 3.24%	40410 apo 3.15%	17195 apo 3.45%
	5 Fushë Kosovë	34827 apo 1.96%	24831 apo 1.94%	9996 apo 2.00%
	6 Obiliq	21549 apo 1.21%	15130 apo 1.18%	6419 apo 1.29%
	7 Graçanicë	10675 apo 0.60%	8012 apo 0.63%	2663 apo 0.53%
PRIZRENI: 277.007 banorë (199.915, me14+vjeç dhe 77.092 nën 14 vjeç)	1 Prizren	177781 apo 9.99%	128582 apo 10.04%	49199 apo 9.86%
	2 Suharekë	59722 apo 3.36%	42313 apo 3.30%	17409 apo 3.49%
	3 Dragash	33997 apo 1.91%	25339 apo 1.98%	8658 apo 1.74%
	4 Mamushë	5507 apo 0.31%	3681 apo 0.29%	1826 apo 0.37%
MITROVICA: 232.833 banorë (166.577 me14+vjeç dhe 66.256 nën 14 vjeç)	1 Mitrovica jugore	71909 apo 4.04%	51558 apo 4.02%	20351 apo 4.08%
	2 Leposaviq	13773 apo 0.77%	9922 apo 0.77%	3851 apo 0.77%
	3 Zubin potok	6616 apo 0.37%	4766 apo 0.37%	1850 apo 0.37%
	4 Zveçan	7481 apo 0.42%	5389 apo 0.42%	2092 apo 0.42%
	5 Mitrovica veriore	12326 apo 0.69%	8879 apo 0.69%	3447 apo 0.69%
	6 Skenderaj	50858 apo 2.86%	35827 apo 2.80%	15031 apo 3.01%
	7 Vushtrri	69870 apo 3.93%	50236 apo 3.92%	19634 apo 3.94%
PEJA: 220.338 banorë (160.986, me14+vjeç dhe 59.352 nën 14 vjeç)	1 Pejë	96450 apo 5.42%	71457 apo 5.58%	24993 apo 5.01%
	2 Deçan	40019 apo 2.25%	29548 apo 2.31%	10471 apo 2.10%
	3 Klinë	38496 apo 2.16%	27098 apo 2.12%	11398 apo 2.29%
	4 Istog	39289 apo 2.21%	28480 apo 2.22%	10809 apo 2.17%
	5 Junik	6084 apo 0.34%	4403 apo 0.34%	1681 apo 0.34%
GJAKOVA: 205.377 banorë (145.156 me14+vjeç dhe 60.221 nën 14 vjeç)	1 Gjakovë	94556 apo 5.31%	69256 apo 5.41%	25300 apo 5.07%
	2 Rahovec	56208 apo 3.16%	40127 apo 3.13%	16081 apo 3.22%
	3 Malishevë	54613 apo 3.07%	35773 apo 2.79%	18840 apo 3.78%
GJILANI: 188.188 banorë (138.348, me14+vjeç dhe 49.840 nën 14 vjeç)	1 Gjilan	90178 apo 5.07%	66714 apo 5.21%	23464 apo 4.70%
	2 Kamenicë	36085 apo 2.03%	27185 apo 2.12%	8900 apo 1.78%
	3 Ranillug	3866 apo 0.22%	3211 apo 0.25%	655 apo 0.13%
	4 Novobërdë	6729 apo 0.38%	5086 apo 0.40%	1643 apo 0.33%
	5 Viti	46987 apo 2.64%	32819 apo 2.56%	14168 apo 2.84%
	6 Klllokot	2556 apo 0.14%	1886 apo 0.15%	670 apo 0.13%
	7 Partesh	1787 apo 0.10%	1447 apo 0.11%	340 apo 0.07%
FERIZAJ: 185.695 banorë (131.418, me14+vjeç dhe 54.277 nën 14 vjeç)	1 Ferizaj	108610 apo 6.10%	77044 apo 6.01%	31566 apo 6.33%
	2 Kaçanik	33409 apo 1.88%	23828 apo 1.86%	9581 apo 1.92%
	3 Shtime	27324 apo 1.54%	18743 apo 1.46%	8581 apo 1.72%
	4 Shtërpce	6949 apo 0.39%	5178 apo 0.40%	1771 apo 0.36%
	5 Hani i Elezit	9403 apo 0.53%	6625 apo 0.52%	2778 apo 0.56%
Totali:		1780021 apo 100%	1281204 apo 100%	498817 apo 100%

Figura 3

II. NDJEKJA PENALE

2.1 PËRFSHIRJA NË RASTET PENALE

Prokuroritë përgjatë viteve 2013–2018, kanë pranuar/regjistruar 10134 kallëzime penale ndaj **16443** personave të dyshuar si kryes të veprave penale karakteristike, të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional (*shih figurën 4*).

#	PROKURORIA	Numri i PERSONAVE të pranuar /regjistruar, në kallëzimet penale PP, gjatë periudhës kohore 2013-2018, për veprat penale karakteristike	Numri i KALLËZIMEVE PENALE të pranuar /regjistruara gjatë periudhës kohore 2013-2018, për veprat penale karakteristike
1	PSRK	1277	239
2	PRISHTINË	5742	3610
3	PRIZREN	2297	1579
4	PEJË	1357	929
5	GJILAN	1588	1083
6	MITROVICË	1801	1184
7	FERIZAJ	1532	937
8	GJAKOVË	849	573
	Gjithsej:	16443	10134

Figura 4

Sipas të dhënave, në tabelën si më sipër, rezulton se Prokuroria Themelore në Prishtinë ka pranuar /regjistruar nivelin më të lartë të personave të dyshuar, në kallëzimet e pranura penale përgjatë viteve 2013-2018, me **34.92%**, ndërsa nivelin më të ulët rezulton të ketë Prokuroria Themelore në Gjakovë, me **5.15%** (*shih figurën 5*).




Figura 5

2.2 TË DYSHUARIT PËR KRYERJEN E VEPRAVE PENALE

Përgjatë viteve 2013-2018, nëpër prokurori janë pranuar/regjistruar **16500** persona të përfshirë në kallëzimet penale për veprat penale karakteristike, prej të cilëve numrin më të lartë rezultojnë të ketë vepra penale e Drogave me **6464** persona apo **39.18%**, ndërsa numrin më të ulët rezultojnë të ketë vepra penale e Nxitjes së urrejtjes me **64** persona apo **0.39%** (shih figurën 6).

	PSRK	PTH PRISHTINË	PTH PRIZREN	PTH PEJË	PTH GJILAN	PTH MITROVICË	PTH FERIZAJ	PTH GJAKOVË	TOTALI: PERSONA	
	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	Persona	%
A	18	42	59	3	23	9	50	9	213	1.29%
DR	62	2363	1038	622	575	809	643	352	6464	39.18%
KM	87	163	44	12	72	25	32	21	456	2.76%
KO	593	4							597	3.62%
KOR	342	2083	627	477	605	385	363	280	5162	31.28%
SHP	118		11						129	0.78%
TNJ	15	186	36	54	41	65	77	37	511	3.10%
E	15	899	534	179	271	502	359	145	2904	17.60%
NU	27	2	8	10	1	6	8	2	64	0.39%
#	1277	5742	2357	1357	1588	1801	1532	846	16500	100%

Figura 6

Prokuroria Themelore në Prishtinë rezultojnë të ketë pranuar numrin më të lartë të personave, me gjithsej 5742 persona të përfshirë në kallëzimet penale të pranuar, apo 34.80% nga numri i përgjithshëm i personave të pranuar përgjatë viteve 2013-2018, ndërsa numrin më të ulët rezultojnë të ketë Prokuroria Themelore në Gjakovë me gjithsej 846 persona të përfshirë në kallëzimet penale për veprat penale karakteristike, apo 5.13% nga numri i përgjithshëm (shih figurën 7).




Figura 7

Theksojmë se në vazhdim të raportit trajtohen vetëm të dhënat për personat e përfshirë në veprat penale karakteristike nëpër prokuroritë themelore, për shkak se prokuroria speciale trajton rastet e personave në gjithë territorin e Republikës.

2.3 PANORAMA GJEOGRAFIKE E TË DYSHUARVE

Shtatë (7) Prokuroritë Themelore⁵, gjatë viteve 2013-2018, kanë pranuar/regjistruar **15166** persona të përfshirë në kallëzimet penale për veprat penale karakteristike. Të dhënat tregojnë se në gjashtë (6) prokurori themelore numri më i lartë i personave i takojnë veprave penale të Drogave, ndërsa në Prokurorinë Themelore në Gjilan numri më i lartë i personave sipas veprës penale i takojnë veprave penale të Korrupsionit (*shih figurën 8*).




Figura 8

⁵ Në këtë analizë nuk janë përfshirë personat në kallëzimet penale të Prokurorisë speciale, pasi që analiza i adresohet shtrirjes territoriale të personave sipas kompetencës territoriale të prokurorive respektive, ndërsa Prokuroria speciale ka kompetencë në tërë territorin e Republikës.

2.4 NDJEKJA PENALE NË DIMENSIONIN KOHOR

Në vitin 2013, Korrupsioni përbënte veprën penale me numrin më të lartë të personave të përfshirë në veprat penale në të gjitha Prokuroritë Themelore, ndërsa në vitin 2018 nivelin më të lartë në shtatë prokurori e përbëjnë veprat penale të Drogave, ndërsa vetëm një prokurori (PTh.Gjilani), rezulton të ketë Korrupsionin si vepër penale me numrin më të lartë të personave të përfshirë në kallëzimet penale (shih figurën 9).




Figura 9

2.5 PROFILI TERRITORIAL I TË DYSHUARËVE PËR VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE

Prokuroritë Themelore gjatë viteve 2013-2018, kanë pranuar/regjistruar **15223** persona të dyshuar në kallëzimet penale për veprat penale karakteristike (*sipas kompetencës territoriale*), të cilët në raport me numrin e përgjithshëm prej **1281204** banorëve resident të përgjegjshëm penalisht përbëjnë **1.19%**, ndërsa duke përfshirë edhe 1277 të persona të pranuar në prokurorinë speciale rezulton se numri i përgjithshëm arrin në 16500 persona të pranuar/regjistruar, të cilët përbëjnë 1.29% të numrit të përgjithshëm të banorëve të përgjegjshëm penalisht në nivel vendi (*shih figurën 10*).

Prokuroria/ Rajoni	Numri i personave të dyshuar për veprat penale karakteristike: 2013-2018	Numri i banorëve penalisht të përgjegjshëm 14+vjeç	Përqindja e të dyshuarve në raport me numrin e banorëve të përgjegjshëm penalisht 14+vjeç
PRISHTINË	5742	338804	1.69%
PRIZREN	2357	199915	1.18%
MITROVICË	1801	166577	1.08%
GJILAN	1588	138348	1.15%
FERIZAJ	1532	131418	1.17%
PEJË	1357	160986	0.84%
GJAKOVË	846	145156	0.58%
Gjithsej:	15223	1281204	1.19%
PSRK	1277		
Nivel vendi	16500	1281204	1.29%

Figura 10

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën si më sipër (*shih figurën 10*), duke përfshirë edhe prokurorinë speciale rezulton se në çdo 77 banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç në nivel të Republikës), një (1) person është i dyshuar për vepër penale karakteristike të Mekanizmit përcjellës ndërinstitucional. Nivelin më të lartë të përfshirjes së të dyshuarve në raport me numrin e banorëve sipas territorit të kompetencës, rezulton të ketë Prokuroria Themelore në Prishtinë, me një (1) të dyshuar në çdo **59** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç), ndërsa nivelin më të ulët rezulton të ketë Prokuroria Themelore në Gjakovë me një (1) të dyshuar në çdo **171** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç) (*shih figurën 11*).




Figura 11

2.5.1 TË DYSHUARIT PËR VEPRAT PENALE TË ARMËVE

Prokuroritë Themelore gjatë viteve 2013-2018, kanë pranuar/regjistruar **195** persona të dyshuar në kallëzimet penale për veprat penale të Armëve, të cilët në raport me numrin e përgjithshëm prej **1281204** banorëve të përgjegjshëm penalisht përbëjnë **0.015%** (shih figurën 12)

ARMËT	Personat e përfshirë në kallëzimet penale për veprat penale: 2013-2018	Numri i banorëve penalisht të përgjegjshëm (14+vjeç)	Përqindja e të dyshuarve në raport me numrin e banorëve të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç)
PRISHTINË	42	338804	0.01%
PRIZREN	59	199915	0.04%
MITROVICË	9	166577	0.005%
GJILAN	23	138348	0.02%
FERIZAJ	50	131418	0.04%
PEJË	3	160986	0.002%
GJAKOVË	9	145156	0.006%
Gjithsej:	195	1281204	0.015%

Figura 12

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën si më sipër (shih figurën 12), rezultojnë se në çdo 6570 banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç në nivel të Republikës), një (1) person është i dyshuar për veprën penale të Armëve. Nivelin më të lartë të përfshirjes rezultojnë të ketë Prokuroria Themelore në Ferizaj, me një (1) të dyshuar në çdo **59** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç), ndërsa nivelin më të ulët rezultojnë të ketë Prokuroria Themelore në Pejë me një (1) të dyshuar në çdo **53662** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç) (shih figurën 13).




Figura 13

2.5.2 TË DYSHUARIT PËR VEPRAT PENALE TË DROGAVE

Prokuroritë Themelore gjatë viteve 2013-2018, kanë pranuar/regjistruar **6402** persona të dyshuar në kallëzimet penale për veprat penale të Drogave, të cilët në raport me numrin e përgjithshëm prej **1281204** banorëve të përgjegjshëm penalisht përbëjnë **0.50%** (shih figurën 14)

NARKOTIKËT /DROGAT	Personat e përfshirë në kallëzimet penale për veprat penale: 2013-2018	Numri i banorëve penalisht të përgjegjshëm (14+vjeç)	Përqindja e të dyshuarve në raport me numrin e banorëve të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç)
PRISHTINË	2363	338804	0.70%
PRIZREN	1038	199915	0.52%
MITROVICË	809	166577	0.49%
GJILAN	575	138348	0.42%
FERIZAJ	643	131418	0.49%
PEJË	622	160986	0.39%
GJAKOVË	352	145156	0.24%
Gjithsej:	6402	1281204	0.50%

Figura 14

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën si më sipër (shih figurën 14), rezulton se në çdo 200 banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç në nivel të Republikës), një (1) person është i dyshuar për veprën penale të Drogave. Nivelin më të lartë të përfshirjes rezulton të ketë Prokuroria Themelore në Prishtinë, me një (1) të dyshuar në çdo **143** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç), ndërsa nivelin më të ulët rezulton të ketë Prokuroria Themelore në Gjakovë me një (1) të dyshuar në çdo **412** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç) (shih figurën 15).

DROGAT




Figura 15

2.5.3 TË DYSHUARIT PËR VEPRËN PENALE TË KONTRABANDIMIT ME MIGRANT

Prokuroritë Themelore gjatë viteve 2013-2018, kanë pranuar/regjistruar **369** persona të dyshuar në kallëzimet penale për veprat penale të Kontrabandimit me migrant, të cilët në raport me numrin e përgjithshëm prej **1281204** banorëve të përgjegjshëm penalisht përbëjnë **0.03%** (shih figurën 16)

KONTRABANDA ME MIGRANT	Personat e përfshirë në kallëzimet penale për veprat penale: 2013-2018	Numri i banorëve penalisht të përgjegjshëm (14+vjeç)	Përqindja e të dyshuarve në raport me numrin e banorëve të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç)
PRISHTINË	163	338804	0.05%
PRIZREN	44	199915	0.02%
MITROVICË	25	166577	0.02%
GJILAN	72	138348	0.05%
FERIZAJ	32	131418	0.02%
PEJË	12	160986	0.01%
GJAKOVË	21	145156	0.01%
Gjithsej:	369	1281204	0.03%

Figura 16

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën si më sipër (shih figurën 16), rezultojnë se në çdo **3472** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç në nivel të Republikës), një (1) person është i dyshuar për veprën penale të Kontrabandimit me migrant. Nivelin më të lartë të përfshirjes rezultojnë të ketë Prokuroria Themelore në Gjilan, me një (1) të dyshuar në çdo **1921** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç), ndërsa nivelin më të ulët rezultojnë të ketë Prokuroria Themelore në Pejë me një (1) të dyshuar në çdo **13415** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç) (shih figurën 17).

KONTRABANDIMI ME MIGRANT




Figura 17

2.5.4 TË DYSHUARIT PËR VEPRAT PENALE TË KORRUPSIONIT

Prokuroritë Themelore gjatë viteve 2013-2018, kanë pranuar/regjistruar **4820** persona të dyshuar në kallëzimet penale për veprat penale të Korrupsionit, të cilët në raport me numrin e përgjithshëm prej **1281204** banorëve të përgjegjshëm penalisht përbëjnë **0.38%** (shih figurën 18)

KORRUPSIONI	Personat e përfshirë në kallëzimet penale për veprat penale: 2013-2018	Numri i banorëve penalisht të përgjegjshëm (14+vjeç)	Përqindja e të dyshuarve në raport me numrin e banorëve të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç)
PRISHTINË	2083	338804	0.61%
PRIZREN	627	199915	0.31%
MITROVICË	385	166577	0.23%
GJILAN	605	138348	0.44%
FERIZAJ	363	131418	0.28%
PEJË	477	160986	0.30%
GJAKOVË	280	145156	0.19%
Gjithsej:	4820	1281204	0.38%

Figura 18

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën si më sipër (shih figurën 18), rezulton se në çdo **266** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç në nivel të Republikës), një (1) person është i dyshuar për veprën penale të Korrupsionit. Nivelin më të lartë të përfshirjes rezulton të ketë Prokuroria Themelore në Prishtinë, me një (1) të dyshuar në çdo **163** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç), ndërsa nivelin më të ulët rezulton të ketë Prokuroria Themelore në Gjakovë me një (1) të dyshuar në çdo **518** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç) (shih figurën 19).

KORRUPSIONI




Figura 19

2.5.5 TË DYSHUARIT PËR VEPRAT PENALE TË TRAFIKIMIT ME NJERËZ

Prokuroritë Themelore gjatë viteve 2013-2018, kanë pranuar/regjistruar **496** persona të dyshuar në kallëzimet penale për veprat penale të Trafikimit me njerëz, të cilët në raport me numrin e përgjithshëm prej **1281204** banorëve të përgjegjshëm penalisht përbëjnë **0.04%** (shih figurën 20).

KORRUPSIONI	Personat e përfshirë në kallëzimet penale për veprat penale: 2013-2018	Numri i banorëve penalisht të përgjegjshëm (14+vjeç)	Përqindja e të dyshuarve në raport me numrin e banorëve të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç)
PRISHTINË	186	338804	0.05%
PRIZREN	36	199915	0.02%
MITROVICË	65	166577	0.04%
GJILAN	41	138348	0.03%
FERIZAJ	77	131418	0.06%
PEJË	54	160986	0.03%
GJAKOVË	37	145156	0.03%
Gjithsej:	496	1281204	0.04%

Figura 20

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën si më sipër (shih figurën 20), rezulton se në çdo **2583** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç në nivel të Republikës), një (1) person është i dyshuar për veprën penale të Trafikimit me njerëz. Nivelin më të lartë të përfshirjes rezulton të ketë Prokuroria Themelore në Ferizaj, me një (1) të dyshuar në çdo **1706** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç), ndërsa nivelin më të ulët rezulton të ketë Prokuroria Themelore në Prizren me një (1) të dyshuar në çdo **5553** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç) (shih figurën 21).

TRAFIKIMI ME NJERËZ




Figura 21

2.5.6 TË DYSHUARIT PËR VEPRAT PENALE TË KRIMEVE EKONOMIKE

Prokuroritë Themelore gjatë viteve 2013-2018, kanë pranuar/regjistruar **2889** persona të dyshuar në kallëzimet penale për veprat penale të Krimeve ekonomike, të cilët në raport me numrin e përgjithshëm prej **1281204** banorëve të përgjegjshëm penalisht përbëjnë **0.23%** (shih figurën 22).

KORRUPSIONI	Personat e përfshirë në kallëzimet penale për veprat penale: 2013-2018	Numri i banorëve penalisht të përgjegjshëm (14+vjeç)	Përqindja e të dyshuarve në raport me numrin e banorëve të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç)
PRISHTINË	899	338804	0.27%
PRIZREN	534	199915	0.27%
MITROVICË	502	166577	0.30%
GJILAN	271	138348	0.20%
FERIZAJ	359	131418	0.27%
PEJË	179	160986	0.11%
GJAKOVË	145	145156	0.10%
Gjithsej:	2889	1281204	0.23%

Figura 22

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën si më sipër (shih figurën 22), rezulton se në çdo **443** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç në nivel të Republikës), një (1) person është i dyshuar për veprën penale të Krimeve ekonomike. Nivelin më të lartë të përfshirjes rezulton të ketë Prokuroria Themelore në Mitrovicë, me një (1) të dyshuar në çdo **332** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç), ndërsa nivelin më të ulët rezulton të ketë Prokuroria Themelore në Gjakovë me një (1) të dyshuar në çdo **1001** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç) (shih figurën 23).

KRIMET EKONOMIKE




Figura 23

2.5.7 TË DYSHUARIT PËR VEPRËN PENALE TË NXITJES SË URREJTJES

Prokuroritë Themelore gjatë viteve 2013-2018, kanë pranuar/regjistruar **37** persona të dyshuar në kallëzimet penale për veprat penale të Nxitjes së urrejtjes, të cilët në raport me numrin e përgjithshëm prej **1281204** banorëve të përgjegjshëm penalisht përbëjnë **0.003%** (shih figurën 24).

KORRUPSIONI	Personat e përfshirë në kallëzimet penale për veprat penale: 2013-2018	Numri i banorëve penalisht të përgjegjshëm (14+vjeç)	Përqindja e të dyshuarve në raport me numrin e banorëve të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç)
PRISHTINË	2	338804	0.0006%
PRIZREN	8	199915	0.004%
MITROVICË	6	166577	0.004%
GJILAN	1	138348	0.0007%
FERIZAJ	8	131418	0.006%
PEJË	10	160986	0.006%
GJAKOVË	2	145156	0.001%
Gjithsej:	37	1281204	0.003%

Figura 24

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën si më sipër (shih figurën 24), rezulton se në çdo **34627** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç në nivel të Republikës), një (1) person është i dyshuar për veprën penale të Nxitjes së urrejtjes. Nivelin më të lartë të përfshirjes rezulton të ketë Prokuroria Themelore në Mitrovicë, me një (1) të dyshuar në çdo **332** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç), ndërsa nivelin më të ulët rezulton të ketë Prokuroria Themelore në Gjakovë me një (1) të dyshuar në çdo **1001** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç) (shih figurën 25).

NXITJA URREJTJES




Figura 25

III. AKUZA

3.1 TË AKUZUARIT PËR VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE

Prokuroritë Themelore dhe prokuroria speciale, gjatë viteve 2013-2018, kanë ngritur **9663** aktakuza kundër të dyshuarve për veprat penale karakteristike të mekanizmit përcjellës ndërinstitucional. Nga ky numër i përgjithshëm i aktakuzave të ngritura, **856** aktakuza i përkasin Prokurorisë speciale ndërsa **8807** aktakuza i përkasin prokurorive themelore, e të cilat në vazhdim të raportit do të jenë pjesë e analizës së profilit rajonal (*shih figurën 26*).

VEPRA PENALE	AKTET AKUZUESE (PËR PERSONA)	PSRK	PR	PZ	PE	GJI	MI	FE	GJA	#
ARMËT	Aktakuzë për dhënien e urdhrit ndëshkimor									
	Aktakuzë e Drejtpërdrejtë			4		5		14	1	24
	Aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve	27	24	43	1	11	6	5	3	120
DROGAT	Aktakuzë për dhënien e urdhrit ndëshkimor		336	181	11	24	23	44	30	649
	Aktakuzë e Drejtpërdrejtë		708	442	220	243	351	287	55	2306
	Aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve	49	367	254	258	246	244	232	174	1824
KONTRABAN DA ME MIGRANT	Aktakuzë për dhënien e urdhrit ndëshkimor									
	Aktakuzë e Drejtpërdrejtë		3			1			1	5
	Aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve	94	80	29	5	52	8	20	14	302
KRIMI I ORGANIZUAR	Aktakuzë për dhënien e urdhrit ndëshkimor									
	Aktakuzë e Drejtpërdrejtë									
	Aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve	307		13 ⁶				2 ⁷		322
KORRUPSIONI	Aktakuzë për dhënien e urdhrit ndëshkimor		8		15		3	50		76
	Aktakuzë e Drejtpërdrejtë	1	89	21	48	31	31	27	10	258
	Aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve	277	618	266	90	222	182	129	143	1927
SHPËRLARJA E PARASË	Aktakuzë për dhënien e urdhrit ndëshkimor									
	Aktakuzë e Drejtpërdrejtë	1								1
	Aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve	42								42
TRAFIKIMI ME NJERËZ	Aktakuzë për dhënien e urdhrit ndëshkimor									
	Aktakuzë e Drejtpërdrejtë		4							4
	Aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve	28	149	24	15	27	61	67	21	392
KRIMET EKONOMIKE	Aktakuzë për dhënien e urdhrit ndëshkimor		36	1	1	9			6	53
	Aktakuzë e Drejtpërdrejtë		76	127	25	91	25	53	13	410
	Aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve	8	307	93	61	72	139	169	58	907
NXITJA URREJTJES	Aktakuzë për dhënien e urdhrit ndëshkimor	18	2							20
	Aktakuzë e Drejtpërdrejtë									
	Aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve	4	1	5	3			7	1	21
Gjithsej:		856	2808	1503	753	1034	1073	1106	530	9663

Figura 26

⁶ Në vitin 2014, PTh.Prizren kishte ngritur aktakuza kundër 13 të dyshuarve për veprën penale krimi i organizuar,

⁷ Në vitin 2014, PTh. Ferizaj kishte ngritur aktakuza kundër 2 të dyshuarve për veprën penale krimi i organizuar;

3.2 PROFILI I TË AKUZUARËVE

Nga 8807 të akuzuarit për veprat penale karakteristike përgjatë viteve 2013-2018 (në këtë analizë nuk përfshihen në përlogaritje 856 të dyshuarit në aktakuzat e Prokurorisë speciale), të akuzuarit për veprat penale të Drogave, me pjesëmarrje prej **53.71%**, përbëjnë nivelin më të lartë të aktakuzave të ngritura kundër të dyshuarve për veprave penale karakteristike, ndërsa nivelin më të ulët rezultojnë të kenë të dyshuarit për veprat penale të Krimin të organizuar për të cilët janë ngritur **0.17%** të aktakuzave nga tërësia e aktakuzave për veprat penale karakteristike përgjatë viteve 2013-2018 (shih figurën 27).




Figura 27

Prokuroria Themelore në Prishtinë rezultojnë të ketë nivelin më të lartë në nivel vendi, me **31.88%** të aktakuzave të ngritura kundër të dyshuarve për veprat penale karakteristike, ndërsa nivelin më të ulët rezultojnë të ketë Prokuroria Themelore në Gjakovë me **6.02%** të aktakuzave të ngritura kundër të dyshuarve për veprat penale karakteristike (shih figurën 28).

- **31.88%** të aktakuzave ndaj të dyshuarve janë ngritur nga PTh. Prishtinë;
- **17.07%** të aktakuzave ndaj të dyshuarve janë ngritur nga PTh. Prizren;
- **12.56%** të aktakuzave ndaj të dyshuarve janë ngritur nga PTh. Ferizaj;
- **12.08%** të aktakuzave ndaj të dyshuarve janë ngritur nga PTh. Mitrovicë;
- **11.74%** të aktakuzave ndaj të dyshuarve janë ngritur nga PTh. Gjilan;
- **8.55%** të aktakuzave ndaj të dyshuarve janë ngritur nga PTh. Pejë;
- **6.02%** të aktakuzave ndaj të dyshuarve janë ngritur nga PTh. Gjakovë.

PROKURORIA		Armët	Drogat	Kontrabanda me migrant	Krimi organizuar	Korrupsioni	Shpërlarja parasë	Trafikimi me njerëz	Krimet ekonomike	Nxitja urrejtjes	#
1	PRISHTINË	24	1411	83		715		153	419	3	2808
2	PRIZREN	47	877	29	13	287		24	221	5	1503
3	PEJË	1	489	5		153		15	87	3	753
4	GJILAN	16	513	53		253		27	172		1034
5	MITROVICË	6	618	8		216		61	164		1073
6	FERIZAJ	19	563	20	2	206		67	222	7	1106
7	GJAKOVË	4	259	15		153		21	77	1	530
#		117	4730	213	15	1983		368	1362	19	8807
PSRK		27	49	94	307	278	43	28	8	22	856

Figura 28

3.3 PANORAMA GJEOGRAFIKE E TË AKUZUARVE

Në kuadër të periudhës kohore 2013-2018, veprat penale të Drogave përbëjnë nivelin më të lartë të të akuzuarve në të gjitha prokuroritë themelore (rreth 50%), në raport me numrin e përgjithshëm të të akuzuarve për veprat penale karakteristike. (shih figurën 31).




Figura 31

3.4 AKUZIMI NË DIMENSIONIN KOHOR

Përderisa në vitet 2013 deri 2016, niveli më i lartë të të akuzuarve, sipas prokurorive themelore, i adresojë veprave penale të Korrupsionit dhe Drogave, në dy vitet e fundit: 2017 dhe 2018 në të gjitha prokuroritë themelore veprat penale të Drogave përbëjnë nivelin më të lartë të personave të akuzuar në raport me të gjitha veprat tjera penale karakteristike (shih figurën 32).




Figura 32

3.5 PROFILI TERRITORIAL I TË AKUZUARVE PËR VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE

Përgjatë viteve 2013-2018, prokuroritë kanë ngritur aktakuza kundër **9963** të dyshurve për veprat penale karakteristike. Ky numër i të dyshuarve përbën **0.78%** të numrit të banorëve të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç), në nivel vendi. Ndërsa, duke mos përllogaritur aktakuzat e prokurorisë speciale (aktakuza kundër 856 të dyshuarve), rezulton se prokuroritë themelore (objekte të analizës së profilit rajonal), kanë ngritur aktakuza kundër **8807** të dyshuarve që përbën **0.69%** të banorëve të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç) në nivel vendi (shih figurën 29).

PROKURORIA	Numri i banorëve penalisht të përgjegjshëm (14+vjeç), sipas rajoneve:2013-2018	Numri i personave të akuzuar për veprat penale karakteristike: 2013-2018, sipas rajoneve:		Përqindja e të akuzuarve në raport me numrin e banorëve (14+vjeç)	Raporti në mes një të akuzuari dhe numrit të banorëve të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç)
PRISHTINË	338804	2808		0.83%	1 në 120
PRIZREN	199915	1503		0.75%	1 në 133
FERIZAJ	131418	1106		0.84%	1 në 118
MITROVICË	166577	1073		0.64%	1 në 155
GJILAN	138348	1034		0.75%	1 në 133
PEJË	160986	753		0.47%	1 në 213
GJAKOVË	145156	530		0.37%	1 në 273
Prokuroritë themelore:	1281204	<i>a</i>	8807	0.69%	1 në 145
PSRK	1281204	<i>b</i>	856	0.07%	1 në 1496
Nivel vendi:	1281204	<i>c (a+b)</i>	9963	0.78%	1 në 128

Figura 29

Sipas të dhënave të pasqyruara në tabelë (shih figurën 29), rezulton se kundër një (1) personi në çdo 128 banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç), në nivel vendi, është ngritur aktakuzë për veprë penale karakteristike. Prokuroritë Themelore (duke mos përfshirë prokurorinë speciale), kanë ngritur aktakuzë kundër një (1) personi në çdo 145 banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç). Përqindjen më të lartë të përfshirjes së të dyshuarve në raport me numrin e banorëve të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç), sipas kriterit territorial e përbën Prokuroria Themelore në Ferizaj me një (1) të akuzuar në çdo **118** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç), ndërsa nivelin më të ulët rezulton të ketë Prokuroria Themelore në Gjakovë me një (1) të akuzuar në çdo **273** banorë (14+vjeç) (shih figurën 30).




Figura 30

3.5.1 ARMËT

Prokuroritë Themelore (në këtë analizë nuk përfshihen aktakuzat e prokurorisë speciale), gjatë viteve 2013-2018, kanë ngritur **117** aktakuza kundër të dyshuarve për veprat penale të Armëve, të cilët në raport me numrin e përgjithshëm prej **1281204** banorëve të përgjegjshëm penalisht përbëjnë **0.009%** (shih fig.33).

ARMËT	Aktakuza të ngritura kundër të dyshuarve: 2013-2018	Numri i banorëve penalisht të përgjegjshëm (14+vjeç)	Përqindja e të akuzuarve në raport me numrin e banorëve të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç)
PRISHTINË	24	338804	0.007%
PRIZREN	47	199915	0.023%
MITROVICË	1	166577	0.0006%
GJILAN	16	138348	0.011%
FERIZAJ	6	131418	0.004%
PEJË	19	160986	0.011%
GJAKOVË	4	145156	0.002%
Gjithsej:	117	1281204	0.009%

Figura 33

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën si më sipër (shih figurën 33), rezultojnë se në çdo **10950** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç në nivel të Republikës), një (1) person është i akuzuar për veprën penale të **Armëve**. Nivelin më të lartë të përfshirjes rezultojnë të ketë Prokuroria Themelore në Prizren, me një (1) të akuzuar në çdo **4253** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç), ndërsa nivelin më të ulët rezultojnë të ketë Prokuroria Themelore në Mitrovicë me një (1) të akuzuar në çdo **166577** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç) (shih figurën 34).




Figura 34

3.5.2 DROGAT

Prokuroritë Themelore (në këtë analizë nuk përfshihen aktakuzat e prokurorisë speciale), gjatë viteve 2013-2018, kanë ngritur **4730** aktakuza kundër të dyshuarve për veprat penale të Drogave, të cilët në raport me numrin e përgjithshëm prej **1281204** banorëve të përgjegjshëm penalisht përbëjnë **0.37%** (shih fig.35).

NARKOTIKËT /DROGAT	Aktakuza të ngritura kundër të dyshuarve: 2013-2018	Numri i banorëve penalisht të përgjegjshëm (14+vjeç)	Përqindja e të akuzuarve në raport me numrin e banorëve të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç)
PRISHTINË	1411	338804	0.42%
PRIZREN	877	199915	0.44%
MITROVICË	489	166577	0.29%
GJILAN	513	138348	0.37%
FERIZAJ	618	131418	0.47%
PEJË	563	160986	0.35%
GJAKOVË	259	145156	0.18%
Gjithsej:	4730	1281204	0.37%

Figura 35

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën si më sipër (shih figurën 35), rezulton se në çdo **270** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç në nivel të Republikës), një (1) person është i akuzuar për veprën penale të **Drogave**. Nivelin më të lartë të përfshirjes rezulton të ketë Prokuroria Themelore në Ferizaj, me një (1) të akuzuar në çdo **212** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç), ndërsa nivelin më të ulët rezulton të ketë Prokuroria Themelore në Gjakovë me një (1) të akuzuar në çdo **560** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç) (shih figurën 36).




Figura 36

3.5.3 KONTRABANDIMI ME MIGRANT

Prokuroritë Themelore (në këtë analizë nuk përfshihen aktakuzat e prokurorisë speciale), gjatë viteve 2013-2018, kanë ngritur **213** aktakuzat kundër të dyshuarve për veprat penale të Kontrabandimit me migrant, të cilët në raport me numrin e përgjithshëm prej **1281204** banorëve të përgjegjshëm penalisht përbëjnë **0.016%** (shih figurën 37).

KONTRABANDA ME MIGRANT	Aktakuza të ngritura kundër të dyshuarve: 2013-2018	Numri i banorëve penalisht të përgjegjshëm (14+vjeç)	Përqindja e të akuzuarve në raport me numrin e banorëve të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç)
PRISHTINË	83	338804	0.024%
PRIZREN	29	199915	0.014%
MITROVICË	5	166577	0.003%
GJILAN	53	138348	0.038%
FERIZAJ	8	131418	0.006%
PEJË	20	160986	0.012%
GJAKOVË	15	145156	0.01%
Gjithsej:	213	1281204	0.016%

Figura 37

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën si më sipër (shih figurën 37), rezultojnë se në çdo **6015** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç në nivel të Republikës), një (1) person është i akuzuar për veprën penale të **Kontrabandimit me migrant**. Nivelin më të lartë të përfshirjes rezultojnë të ketë Prokuroria Themelore në Gjilan, me një (1) të akuzuar në çdo **2610** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç), ndërsa nivelin më të ulët rezultojnë të ketë Prokuroria Themelore në Mitrovicë me një (1) të akuzuar në çdo **33315** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç) (shih figurën 38).

KONTRABANDA ME MIGRANT




Figura 38

3.5.4 KORRUPSIONI

Prokuroritë Themelore (në këtë analizë nuk përfshihen aktakuzat e prokurorisë speciale), gjatë viteve 2013-2018, kanë ngritur **1983** aktakuza kundër të dyshuarve për veprat penale veprat penale të Korrupsionit, të cilët në raport me numrin e përgjithshëm prej **1281204** banorëve të përgjegjshëm penalisht përbëjnë **0.15%** (shih figurën 39).

KORRUPSIONI	Aktakuza të ngritura kundër të dyshuarve: 2013-2018	Numri i banorëve penalisht të përgjegjshëm (14+vjeç)	Përqindja e të akuzuarve në raport me numrin e banorëve të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç)
PRISHTINË	715	338804	0.21%
PRIZREN	287	199915	0.14%
MITROVICË	153	166577	0.09%
GJILAN	253	138348	0.18%
FERIZAJ	216	131418	0.16%
PEJË	206	160986	0.13%
GJAKOVË	153	145156	0.11%
Gjithsej:	1983	1281204	0.15%

Figura 39

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën si më sipër (shih figurën 39), rezulton se në çdo **646** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç në nivel të Republikës), një (1) person është i akuzuar për veprën penale të **Korrupsionit**. Nivelin më të lartë të përfshirjes rezulton të ketë Prokuroria Themelore në Prishtinë, me një (1) të akuzuar në çdo **473** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç), ndërsa nivelin më të ulët rezulton të ketë Prokuroria Themelore në Mitrovicë me një (1) të akuzuar në çdo **1088** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç) (shih figurën 40).




Figura 40

3.5.4 TRAFIKIMI ME NJERËZ

Prokuroritë Themelore (në këtë analizë nuk përfshihen aktakuzat e prokurorisë speciale), gjatë viteve 2013-2018, kanë ngritur **368** aktakuza kundër të dyshuarve për veprat penale të Trafikimit me njerëz, të cilët në raport me numrin e përgjithshëm prej **1281204** banorëve të përgjegjshëm penalisht përbëjnë **0.028%** (shih figurën 41).

KORRUPSIONI	Aktakuza të ngritura kundër të dyshuarve: 2013-2018	Numri i banorëve penalisht të përgjegjshëm (14+vjeç)	Përqindja e të akuzuarve në raport me numrin e banorëve të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç)
PRISHTINË	153	338804	0.045%
PRIZREN	24	199915	0.012%
MITROVICË	15	166577	0.009%
GJILAN	27	138348	0.019%
FERIZAJ	61	131418	0.046%
PEJË	67	160986	0.041%
GJAKOVË	21	145156	0.014%
Gjithsej:	368	1281204	0.028%

Figura 41

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën si më sipër (shih figurën 41), rezulton se në çdo **3481** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç në nivel të Republikës), një (1) person është i akuzuar për veprën penale të Trafikimit me njerëz. Nivelin më të lartë të përfshirjes rezulton të ketë Prokuroria Themelore në Ferizaj, me një (1) të akuzuar në çdo **2154** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç), ndërsa nivelin më të ulët rezulton të ketë Prokuroria Themelore në Mitrovicë me një (1) të akuzuar në çdo **11105** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç) (shih figurën 42).




Figura 42

3.5.6 KRIMET EKONOMIKE

Prokuroritë Themelore (në këtë analizë nuk përfshihen aktakuzat e prokurorisë speciale), gjatë viteve 2013-2018, kanë ngritur **1362** aktakuza kundër të dyshuarve për veprat penale veprat penale të Krimeve ekonomike, të cilët në raport me numrin e përgjithshëm prej **1281204** banorëve të përgjegjshëm penalisht përbëjnë **0.10%** (shih figurën 43).

KORRUPSIONI	Aktakuza të ngritura kundër të dyshuarve: 2013-2018	Numri i banorëve penalisht të përgjegjshëm (14+vjeç)	Përqindja e të akuzuarve në raport me numrin e banorëve të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç)
PRISHTINË	419	338804	0.12%
PRIZREN	221	199915	0.11%
MITROVICË	87	166577	0.05%
GJILAN	172	138348	0.12%
FERIZAJ	164	131418	0.12%
PEJË	222	160986	0.13%
GJAKOVË	77	145156	0.05%
Gjithsej:	1362	1281204	0.10%

Figura 43

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën si më sipër (shih figurën 43), rezulton se në çdo **940** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç në nivel të Republikës), një (1) person është i akuzuar për veprën penale të **Krimeve ekonomike**. Nivelin më të lartë të përfshirjes rezulton të ketë Prokuroria Themelore në Pejë, me një (1) të akuzuar në çdo **725** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç), ndërsa nivelin më të ulët rezulton të ketë Prokuroria Themelore në Mitrovicë me një (1) të akuzuar në çdo **1914** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç) (shih figurën 44).




Figura 44

3.5.7 NXITJA E URREJTJES

Prokuroritë Themelore (në këtë analizë nuk përfshihen aktakuzat e prokurorisë speciale), gjatë viteve 2013-2018, kanë ngritur **19** aktakuza kundër të dyshuarve për veprat penale veprat penale të Nxitjes së urrejtjes, të cilët në raport me numrin e përgjithshëm prej **1281204** banorëve të përgjegjshëm penalisht përbëjnë **0.001%** (shih figurën 45).

KORRUPSIONI	Aktakuza të ngritura kundër të dyshuarve: 2013-2018	Numri i banorëve penalisht të përgjegjshëm (14+vjeç)	Përqindja e të akuzuarve në raport me numrin e banorëve të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç)
PRISHTINË	3	338804	0.0008%
PRIZREN	5	199915	0.002%
MITROVICË	3	166577	0.001%
GJILAN	-	138348	-
FERIZAJ	-	131418	-
PEJË	7	160986	0.004%
GJAKOVË	1	145156	0.0006%
Gjithsej:	19	1281204	0.001%

Figura 45

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën si më sipër (shih figurën 45), rezulton se në çdo **67431** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç në nivel të Republikës), një (1) person është i akuzuar për veprën penale të Nxitjes së urrejtjes. Nivelin më të lartë të përfshirjes rezulton të ketë Prokuroria Themelore në Pejë, me një (1) të akuzuar në çdo **22998** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç), ndërsa nivelin më të ulët rezulton të ketë Prokuroria Themelore në Gjakovë me një (1) të akuzuar në çdo **145156** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç) (shih figurën 46).

NXITJA URREJTJES




Figura 46

IV. GJYKIMI

4.1 VENDIMET E GJYKATËS

Gjykatat gjatë periudhës kohore: 2013-2018, kanë marrë **2793** vendime⁸ ndaj të akuzuarve në aktet akuzuese të prokurorive themelore dhe prokurorisë speciale (shih figurën 47).

	VENDIMET E GJYKATËS	PSRK	PR	PZ	PE	GJI	MI	FE	GJA	#
ARMËT	Aktakuza është HUDHUR			1				2		3
	I akuzuari është shpallur FAJTOR	2	2	20	3	3		5	3	38
	I akuzuari është LIRUAR			5						5
	Aktakuza është REFUZUAR			1				1		2
DROGAT	Aktakuza është HUDHUR			21	2	2	1	11	2	39
	I akuzuari është shpallur FAJTOR	9	69	444	177	66	73	257	109	1204
	I akuzuari është LIRUAR	12	2	9		3		5	2	33
	Aktakuza është REFUZUAR		2	4	1		5	5	11	28
KONTRABAN DA ME MIGRANT	Aktakuza është HUDHUR			2					1	3
	I akuzuari është shpallur FAJTOR	16	15	30	2	16	1	16	5	101
	I akuzuari është LIRUAR	2		1	1					4
	Aktakuza është REFUZUAR	1		1		1				3
KRIMI I ORGANIZUAR	Aktakuza është HUDHUR	12								12
	I akuzuari është shpallur FAJTOR	7								7
	I akuzuari është LIRUAR	1								1
	Aktakuza është REFUZUAR	2								2
KORRUPSIONI	Aktakuza është HUDHUR	3	38	10	6	3	12	2	9	83
	I akuzuari është shpallur FAJTOR	25	111	119	66	21	29	81	33	485
	I akuzuari është LIRUAR	5	51	75	17	9	11	18	30	216
	Aktakuza është REFUZUAR	5	55	30			3	12	9	114
SHPËRLARJA E PARASË	Aktakuza është HUDHUR									
	I akuzuari është shpallur FAJTOR	6								6
	I akuzuari është LIRUAR									
	Aktakuza është REFUZUAR	2								2
TRAFIKIMI ME NJERËZ	Aktakuza është HUDHUR				1				1	2
	I akuzuari është shpallur FAJTOR	4	11	13	6	7	1	31	7	80
	I akuzuari është LIRUAR		1	3				3	2	9
	Aktakuza është REFUZUAR							4		4
KRIMET EKONOMIKE	Aktakuza është HUDHUR		4	4		9	1	9		27
	I akuzuari është shpallur FAJTOR	4	38	60	8	19	3	69	31	232
	I akuzuari është LIRUAR		1	2		1	8			12
	Aktakuza është REFUZUAR		1	16		2		5	4	28
NXITJA URREJTJES	Aktakuza është HUDHUR									
	I akuzuari është shpallur FAJTOR			1				6		7
	I akuzuari është LIRUAR		1							1
	Aktakuza është REFUZUAR									
		118	402	872	290	162	148	542	259	2793

Figura 47

⁸ Sipas të dhënave nga zyra e statistikave të NJSHP/KPK.

4.2 PROFILI I TË DËNUARVE

Gjykatat Themelore, gjatë viteve 2013-2018, kanë shpallur fajtor **2160** të akuzuar për veprat penale karakteristike nga prokuroritë themelore dhe prokuroria speciale, prej të cilëve numrin më të lartë rezulton të kenë veprat penale të Drogave me **1204** të akuzuar apo **55.74%**, ndërsa numrin më të ulët vepra penale e shpërlarjes së parasë me **6** të akuzuar apo **0.28%** (shih figurën 48).

#	GJYKATA THEMELORE	Armët	Drogat	Kontrabanda me migrant	Krimi organizuar	Korrupsioni	Shpërlarja parasë	Trafikimi me njëjërën	Krime ekonomike	Nxitja urrejtjes	Gjithsej:
1	PRISHTINË	2	69	15		111		11	38		246
2	PRIZREN	20	444	30		119		13	60	1	687
3	PEJË	3	177	2		66		6	8		262
4	GJILAN	3	66	16		21		7	19		132
5	MITROVICË		73	1		29		1	3		107
6	FERIZAJ	5	257	16		81		31	69	6	465
7	GJAKOVË	3	109	5		33		7	31		188
a	Pr. Themelore:	36	1195	85		460		76	228	7	2087
b	PSRK ⁹	2	9	16	7	25	6	4	4		73
a+b	Të gjitha prokuroritë	38	1204	101	7	485	6	80	232	7	2160

Figura 48

Veprat penale të Korrupsionit rezultojnë të kenë nivelin më të lartë të aktgjykimeve fajësuese nga gjykata e shkallës së parë në rajonin e Prishtinës, ndërsa në të gjitha rajonet tjera rezulton vepra penale e Drogave me nivelin më të lartë të aktgjykimeve fajësuese (shih figurën 49).




Figura 49

⁹ Rastet e personave në lëndët e prokurorisë speciale, nuk janë përfshirë në këtë përlogaritje për shkak të kompetencës territoriale së saj në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

4.3 DËNIMI NË DIMENSIONIN KOHOR

Niveli më i lartë i të dënuarve, përgjatë viteve 2013-2018, i adresohet veprave penale të Drogave, ndërsa Prishtina që nga viti 2015 rezulton të ketë veprat penale të Korrupsionit me nivelin më të lartë të dënuarve (*shih figurën 50*).




Figura 50

4.4 PROFILI TERRITORIAL I TË DËNUARVE PËR VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE

Gjykatat e shkallës së parë, përgjatë viteve 2013-2018, kanë dënuar **2160** të akuzuar për veprat penale karakteristike, që rezultojnë me pjesëmarrjen e një të dënuari në çdo **593** banorë (14+vjeç), apo në përqindje prej **0.17%** (shih figurën 51).

RAJONI	Numri i të dënuarve (2013-2018)	Numri i banorëve penalisht të përgjegjshëm (14 + vjeç)	Përqindja e të dënuarve në raport me numrin e banorëve (14+vjeç)	Raporti në mes një të dënuari dhe numrit mesatar të banorëve të përgjegjshëm penalisht
PRISHTINË	246	338.804	0.07%	1377
PRIZREN	687	199.915	0.34%	291
MITROVICË	262	166.577	0.16%	635
PEJË	132	160.986	0.08%	1219
GJAKOVË	107	145.156	0.07%	1356
GJILAN	465	138.348	0.34%	297
FERIZAJ	188	131.418	0.14%	699
Gjithsej:	2087	1.281.204	0.16%	Një i dënuar në 613 banorë
PSRK ¹⁰	73			
Nivel vendi	2160	1.281.204	0.17%	Një i dënuar në 593 banorë

Figura 51

Nivelin më të lartë të të dënuarve në raport me numrin e banorëve të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç), rezultojnë të ketë Prizreni me një të dënuar në çdo 291 banorë, ndërsa nivelin më të ulët rezultojnë të ketë Prishtina me një të dënuar në çdo 1377 banorë (shih figurën 52).




Figura 52

¹⁰ Një (1) person i dënuar në rastet e PSRK-së, mesatarisht në 28.471 banorë të përgjegjshëm penalisht, në nivel vendi.

4.4.1 ARMËT

Gjatë viteve 2013-2018, gjykatat themelore¹¹ me aktgjykim fajësues kanë dënuar **38** të akuzuar për veprat penale të Armëve, e të cilët në raport me numrin e përgjithshëm prej **1281204** banorëve të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç), rezulton me një (1) të dënuar në çdo **33715** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç) (shih figurën 53).

ARMËT	Të dënuarit: 2013-2018	Numri i banorëve penalisht të përgjegjshëm (14+vjeç)	Një i dënuar në raport me numrin e banorëve 14+vjeç
PRISHTINË	2	338804	169402
PRIZREN	20	199915	9995
MITROVICË		166577	
GJILAN	3	138348	46116
FERIZAJ	5	131418	26283
PEJË	3	160986	53662
GJAKOVË	3	145156	48385
Gjithsej:	38	1281204	33715

Figura 53

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën si më sipër (shih figurën 53), rezulton se niveli më i lartë i të dënuarve me aktgjyqimeve fajësuese për veprat penale të Armëve i adresohet Prokurorisë Themelore në Prizren, me një (1) të dënuar në çdo **9995** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç), ndërsa nivelin më të ulët rezulton të ketë Prokuroria Themelore në Prishtinë me një (1) të dënuar në çdo **169402** banorë të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç) (shih figurën 54).




Figura 54

¹¹ Në këtë analizë (aktgjyqimet fajësuese të gjykatës ndaj të akuzuarve për veprat penale karakteristike), nuk janë përfshirë vendimet e gjykatave lidhur me aktakuzat e ngritura nga Prokuroria speciale.

4.4.2 DROGAT

